

**Pjesëmarrja e KLSH-së në tryezën e diskutimit "Mbi standardet dhe praktikat e procesit raportues ne Kuvendin e Republikës se Shqipërisë" në datën 21 qershor, organizuar nga Instituti i Studimeve Politike**

Në datën 21 qershor, u zhvillua tryeza e diskutimit "Mbi standardet dhe praktikat e procesit raportues ne Kuvendin e Republikës se Shqipërisë", organizuar nga Instituti i Studimeve Politike, për grupin e institucioneve: Kontrolli i Lartë i Shtetit, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit (ILDKPKI) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP).



Gjatë fjalës hapëse të takimit, z. Afrim Krasniqi në cilësinë e Drejtorit Ekzekutiv të Institutit të Studimeve Publike, falënderoi të pranishmit për pjesëmarrjen duke paraqitur shkurtimisht disa nga problematikat e hasura referuar draft raportit mbi monitorimin, me fokus situatën e raportimeve vjetore pranë Kuvendit. Fjala e tij u pasua nga znj. Valbona Kuko, Drejtore e WFD në Shqipëri, e cila theksoi rëndësinë që kanë takime të tilla në kuadër të projektit “Rritja e llogaridhënies së qeverisë përmes një Parlamenti më reagues”, të realizuar nga Fondacioni Westminster për Demokracinë (WFD), me mbështetjen financiare të Ambasadës Britanike në Tiranë. Më pas, Z. Zef Preçi në cilësinë e ekspertit (ACER) prezantoi disa nga gjetjet kryesore dhe rekomandimet shoqëruese të raportit të hartuar. Ai ftoi të pranishmit për një dialog institucional për trajtimin e tyre, në funksion të jetësimit të standardeve të raportimeve vjetore dhe procesit të mbikëqyrjes parlamentare, për një rol sa më aktiv parlamentar në rritjen e treguesve të transparencës, llogaridhënies dhe integritetit.

Në pjesën tjetër të takimit, përfaqësuesit e Kuvendit të pranishëm në këtë takim prezantuan disa nga tipologjitë kryesore të problematikave të hasura gjatë raportimeve të institucioneve të pavarura. Institucionet e pavarura të pranishme në këtë takim diskutuan mbi disa nga gjetjet e raportit, për të cilat disponoheshin dokumentacione dhe informacione që nuk ishin reflektuar në draft raportin e hartuar, dhe për të cilat përfaqësuesit e Institutit të Studimeve Politike shprehën

gatishmërinë e tyre për t'u njohur zyrtarisht me to pas këtij takimi, me qëllim pasqyrimin e një situatë sa më të plotë dhe reale në raportin e monitorimit.

Në këtë takim KLSH u përfaqësua nga Drejtori i Departamentit të Auditimit të Buxhetit të Shtetit, Z. Gjovalin Preçi dhe audituesja znj. Joana Troqe. Z. Preçi në fjalën e tij shprehu qëndrimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit për disa nga çështjet e trajtuara në draft raport, duke u ndalur konkretisht në gjetjet e draft raportit dhe për t'i ballafaquar ato me informacionet shtesë të administruara.

Në përfundim, organizatorët falënderuan të pranishmit për pjesëmarrjen e tyre dhe theksuan edhe njëherë, rolin thelbësorë që institucionet e pavarura luajnë për funksionimin e një shteti demokratik, parimit kushtetues të ndarjes së balancës së pushteteve, mbrojtjen e interesit publik dhe të drejtat e lirive themelore të qytetarëve.